



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Mbi trajtimin e kërkesës për informim.

ZNJ. DH. S.

Në përgjigje të shkresës tuaj, protokolluar me tonën nr. 2859 datë 28.05.2024, nëpërmjet së cilës, bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, kërkonti informacion në lidhje me numrin e punonjësve me funksion Inspektor dhe Drejtor i Përgjithshëm, të deklaruar në Regjistrin Qendror të Personelit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPI), për muajt Nëntor 2022, Dhjetor 2022 dhe Janar 2023, ju bëjmë me dije se:

Kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të Departamentit të Administratës Publike (DAP), me numrin rendor 17, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar. Për çdo kërkesë tuajën për informim ju mund t’i drejtoheni adresës së kontaktit të pasqyruar në faqen tonë zyrtare: info@dap.gov.al.

Lidhur me të dhënat e kërkuara nga ana juaj, sqarojmë se, në pikat 2 dhe 3, të kreut III, të VKM-së nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” përcaktohet se:

“2. Të dhënat parësore që reflektohen në RQP, janë:

- a) të dhëna që lidhen me institucionin;*
- b) të dhëna që lidhen me të punësuarit.*

3. Të dhënat parësore që lidhen me institucionin, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të këtij kreu, janë:

- a) krijimi, mbyllja, bashkimi, ndarja, ristrukturimi, ndryshimi i emrit të institucionit, numri unik dhe adresa;*
- b) të dhëna të tjera për institucionin që tregojnë:*
 - i. kategorinë e institucioneve së cilës ai i përket (administratë shtetërore – qendror/ rajonal/ vendor, të pavarur, pushtet vendor, sistem gjyqësor etj.);*
 - ii. varësinë e institucionit;*
- c) organizimi i brendshëm (struktura dhe organika);*
- ç) të dhënat për pozicionet e punës, ku përfshihen:*
 - i. numri unik i pozicionit;*

- ii. klasa/kategoria e pagës;
- iii. legjislacioni për rregullimin e marrëdhënies së punës;
- iv. përshkrimi i punës.”

Më tej, në pikën 2, të kreut IV, të kësaj VKM-je, përcaktohet shprehimisht se:

“2. Institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të hedhin e të përditësojnë në RQP:

a) të dhënat parësore të përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 3, të kreut III, të këtij vendimi, për institucionin e tyre;

b) të dhënat parësore të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 3, të kreut III, të këtij vendimi, për institucionin e tyre;

c) të dhënat parësore të përcaktuara në pikën 4, të kreut III, të këtij vendimi;

ç) informacionin e nevojshëm për llogaritjen e pagës mujore;

d) informacionet financiare të nevojshme për automatizimin e pagës mujore.

Për sa më sipër, ILDKPI është institucioni përgjegjës që ka detyrimin për të hedhur dhe për të përditësuar në Regjistrin Qendror të Personelit, të dhënat e kërkuara nga ana juaj. Të drejtat dhe detyrimet e të gjithë përdoruesve të Regjistrit Qendror të Personelit, përfshirë këtu dhe DAP-in, përcaktohen në mënyrë shteruese në VKM-në nr. 833 datë 28.10.2020, të sipërcituar. Në këto kushte, institucioni jonë nuk mund të tejkalojë të drejtat dhe kompetencat, që janë përcaktuar në këtë VKM, por ju duhet t’i drejtoheni ILDKPI-së lidhur me informacionin e kërkuar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,